

Gugash Magani: Na duhen perforcime urgjente

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 21 Dhjetor 2013 17:15



Trajneri i Tiranës Gugash Magani, u vu perballe ish skuadres se tij Teuta per here te pare kete sezon. "Ishte ndeshje emocionuese, por une tek Teuta kam kaluar mire, ashtu sic kam kaluar tek cdo skuader qe kam qene. Kete e ka thene edhe Presidenti. Sot sic e pate djemte u munduan por mungon finalizimi. Kur erdha tek Tirana, kerkova 5-6perforcime, te cilat jane imediate edhe pse djemte qe kam ne dispozicion jane te mire. Une nuk dua te largoj asnje nga skuadra sepse ata jane te gjithë me kontrate dhe nuk eshte normale ti heq, por na duhen perforcime patjeter, sepse jemi ne gjendje shume te veshtire dhe nga Kategoria bien 4 skuadra. Lodhja pas ndeshjes se gjate shtese ne mesjave per Kupe u ndje edhe ne takimin e sotem ku sic e pate lame 2 pike. Perforcimet e Janarit duhen bere urgjent dhe personalisht mund te them se preferoj lojtare shqiptare, pasi eshte me e lehte sesa te huajt qe ti ingranosh ne sistem", perfundoi Magani